




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË VITISË PËR VITIN 2023

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Vitisë për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Vitisë (K.V), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Vitisë, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për Opinion të Kualifikuar

B1 Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2023 transaksione në vlerë 436,088€ ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate. Prej tyre nga investimet kapitale ishin realizuar 253,717€, nga komunalit 69,798€, si dhe nga subvencionet 112,573€.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Vitisë kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- B2 Në 26 raste për pagesat për mallra dhe shërbime, zotimi i mjeteve dhe urdhërblertet ishin proceduar pas pranimi të mallit/ faturës.
- B3 Komuna kishte të angazhuar 33 zyrtarë me kontrata për shërbime të veçanta, dhe për ta nuk kishte zhvilluar procedura të prokurimit siç kërkohet me ligjin për zyrtarët publik.
- B4 Në pesë (5) raste faturat/obligimet në vlerë 84,079€ nuk ishin paguar brenda afatit kohorë ligjor prej 30 ditësh.
- B5 Komuna ka përdorë fondet e projekteve për qëllime tjera nga ajo për çka ishin planifikuar, pa i zbatuar procedurat dhe kriteret për transferim dhe rialokim të ndarjeve buxhetore.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Vitisë.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Vitisë është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Vitisë në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Vitisë me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohem ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Vitisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, ne kemi vërejtur fusha ku nevojiten përmirësime të dukshme, rreth menaxhimit financiar dhe Kontrollit. Dobësi evidente janë vërejtur në fusha të rëndësishme financiare si: Keq klasifikimi i shpenzimeve si rezultat i pagesave me vendime gjyqësore për zbatim të kontratës kolektive, mangësi në procedim të pagesave, vonesa në pagesën e obligimeve, dobësitë në menaxhimin e pasurive si dhe auditimin e brendshëm të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të përmirësojnë informacionin financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Gjithashtu, duhet të theksojmë se për vitin 2023, Thesari kishte ekzekutuar përmes procedurave përbarimore/gjyqësore vlerën prej 436,088€, prej tyre shpenzime të interesit dhe përbarimit ishin 158,607€, për obligimet që kanë dalë nga kontrata kolektive. Këto shpenzime kanë të bëjnë me pagesat që janë bërë për shujta për kontratën kolektive.

Ky raport ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime, prej tyre një (1) është rekomandim i ri, shtatë (7) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategorinë ekonomike

Gjetja Rregulla financiare nr. 01/2013 për shpenzimet publike, neni 18, pika 3 përcakton se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Po ashtu, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA.

Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2023 transaksione në vlerë 436,088€ ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate. Prej tyre nga investimet kapitale ishin realizuar 253,717€, nga komunalit 69,798€, si dhe nga subvencionet 112,573€

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet. Megjithatë, këto pagesa janë ekzekutuar nga thesari.

Ndikimi Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve . Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PVF.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të vazhdojë përpjekjet në bashkëpunim me MF për të zgjidhur çështjen e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për pagesat e parapara me kontratën kolektive në mënyrë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PVF sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja B2 - Urdhërblerjet dhe zotimet pas pranimit mallit/faturës

Gjetja	<p>Neni 22 i Rregullës financiare për shpenzimin e parasë publike, fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, zotimi i mjeteve, procedohet urdhërblerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa.</p> <p>Në 26 raste për pagesat në vlerë 414,573€ për mallra dhe shërbime, zotimi i mjeteve dhe urdhërblerjet ishin proceduar pas pranimit të mallit/ faturës.</p> <p>Shkaku i dobësive në procedimin e pagesave ka ndodhur si rezultat i kontrolleve të dobëta në procesin e realizimit të blerjeve.</p>
Ndikimi	Procedimi i pagesave si më sipër, paraqet shmangie të procedurave të përcaktuara me rregullat financiare dhe rritë rrezikun që të pranohen mallra apo shërbime jo në pajtim me kushtet e kontraktuara.
Rekomandimi B2	Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Angazhimi i punonjësve me kontrata për shërbime të veçanta pa procedura ligjore

Gjetja	<p>Neni 84 i Ligjit për Zyrtarët Publik nr. 06/L-114 thekson se - Marrëveshjet për shërbime të veçanta, lidhen sipas legjislacionit përkatës të prokurimit publik. Derisa sipas paragrafit 4 të ndryshim plotësimit të rregullave të KRPP-së për prokurim të shërbimeve të veçanta (konsulent/kontraktorët individual) këto rregulla aplikohen vetëm për prokurimin e shërbimeve të veçanta të cilat nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit.</p> <p>Angazhimi i stafit me kontrata për shërbime të veçanta nga Komuna e Vitisë kishte vazhduar edhe gjatë vitit 2023. Pavarësisht zvogëlimit të numrit nga 80 sa ishte në vitin 2022, në vitin 2023, komuna kishte të angazhuar 33 punonjës me këto kontrata për të mbuluar pozita të rregullta të punës , dhe për këto angazhime nuk kishte zhvilluar asnjë lloj procedure, qoftë përmes prokurimit, apo procesit të rregullt të rekrutimit. Shumica nga këta zyrtar punojnë në pozita të rregullta të punës si: në Zyrën e Kryetarit, Drejtorinë për financa, Administratë, Prokurim, Gjeodezi dhe Kadastër, Arsim, Shëndetësi, Bujqësi etj. Të njëjtit janë paguar nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve (përfshirë edhe kontributet pensionale dhe tatimin në pagë).</p> <p>Angazhimi i punonjësve me marrëveshje për shërbime të veçanta jo në pajtueshmëri me rregullat e përcaktuara ishte bërë si pasojë e mos zbatimit të kontrolleve të brendshme, edhe pse Zyra Kombëtare e Auditimit për disa vite ka rekomanduar zbatimin e procedurave të përcaktuara për shërbime të veçanta.</p>
---------------	--

Ndikimi Anashkalimi i procedurave të prokurimit apo procedurave tjera përkatëse për angazhim të stafit, përveç që përbën shkelje ligjore pasi që eliminohet parimi i transparencës dhe konkurrencës, gjithashtu rritë rrezikun e angazhimit të personave jo adekuat për pozita dhe detyra të caktuara, e që mund të reflektojë edhe në performancën e tyre në punë.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se do të ndiqen procedura adekuate ligjore me rastin e angazhimit të stafit, në mënyrë që personat e angazhuar do të plotësojnë të gjithat kriteret për pozitat përkatëse, qoftë përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta, apo në rast të pozitave të rregullta fillimisht të bëhet planifikimi sipas ligjit të buxhetit, e pastaj të zhvillohet proces i rregullt i rekrutimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B4 - Vonesa në pagesën e Obligimeve

Gjetja Sipas nenit 39.1 të ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), Çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore duhet të paguhet brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës.

Nga mostrat e testuara, kemi vërejtur se në pesë (5) raste faturat/obligimet në vlerë 84,079€ nuk ishin paguar brenda afatit kohorë ligjor prej 30 ditësh. Vonesat për pagesat kanë qenë nga 32-95 ditë.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme, si dhe buxhetit të pamjaftueshëm.

Ndikimi Vonesat në kryerjen e obligimeve mund t'i shkaktojnë kosto shtesë komunës për shkak se ajo mund të përballet me padi ku përveç vlerës së faturës duhet t'i paguaj kostot shtesë përfshirë kamatën, interesin dhe shpenzimet gjyqësore.

Rekomandimi B4 Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë të përmbarimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B5 - Ekzekutimi i pagesave për projekte të caktuara nga buxheti i projekteve tjera

Gjetja Ligji nr. 08/L-193 mbi ndarjet buxhetore për vitin 2023, neni 16 pika 10.9. Për çdo projekt të ri kapital që shtohet në tabelën 4.2., kërkohet aprovimi paraprak nga Kuvendi Komunal. Pika 11. Ndryshimet në shumat e ndara buxhetore për projektet ekzistuese si rezultat i transfereve dhe/ose rialokimeve, të prezantuara në tabelën 4.2., duke përfshirë edhe të hyrat vetanake të bartura, si dhe të regjistruara në SIMFK, duhet të aprovohen paraprakisht nga Kuvendi Komunal. Rialokimet duhet të kryhen në përputhje me procedurat dhe kriteret e parapara me udhëzimin administrativ MF nr. 05/2019 për procedurat e transferit dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore.

Në një rast në vlerë 50,000€, kemi identifikuar se komuna ka përdorë fondet e projektit për qëllime tjera nga ajo për çka ishin planifikuar. Pra, për projektin ndërtimi i objektit të zjarrfikësve, janë bartur mjetet vetëm me vendim të kryetarit nga projekti kapital “Ndërtimi I palestrave sportive”. Për më tepër, nuk ka aprovim nga Kuvendi Komunal për ridestinim të mjeteve dhe rialokimit të ndarjeve buxhetore nga një projekt kapital në një tjetër.

Kjo ka ndodhur për shkak të hyrjes në kontrata publike pa mjete të mjaftueshme për projekte të caktuara.

Ndikimi

Kjo ndikon në prezantime të gabuara të raporteve të progresit fizik dhe financiar të projekteve kapitale dhe rrezikon që buxhetimet e viteve vijuese të bëhen të pa sakta, po ashtu rritë mundësinë e vonesave në pagesa për projektet tjera.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të pagesave për investime kapitale për të gjitha rastet, të respektohen shumat dhe kodet e projektit përkatës siç janë të miratuara në ligjin e ndarjeve buxhetore, dhe nëse paraqitet nevoja për ndryshimin e shumave apo të projekteve atëherë të kërkohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga Komuna e Vitisë në vitin 2023 në total ishin 1,232,853€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara nga Komuna të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjobat e gjykatave, gjobat pyjore dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 201,238€.

Çështja A1 - Mangësi në databazën e tatimit në pronë

Gjetja

Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, neni 11 pika 1 definon:” Zbritja për vendbanimin parësor- Personi fizik, i cili vendos deri më 30 nëntor të vitit, para vitit tatimor se njësia e objektit shërben si vendbanim parësor dhe e deklaron këtë në komunë apo gjatë fazës së inspektimit, i lejohet zbritja prej 15,000€ nga vlera e vlerësuar e njësisë së objektit. Po ashtu, Ministria e Financave përkatësisht Departamenti i Tatimit në Pronë ka njoftuar komunat për vendimin e marr për regjistrimin e numrit personal në rastin e zbatimit të nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-005, kjo me qëllim të shmangies së duplikimeve/apo parregullsive dhe sigurimin e zbatimit efektiv të këtij neni.

- Nga analiza e data bazës për tatimin në pronë të siguruar nga komuna, kemi vërejtur se 188 personave iu ishte bërë zbritja pa numër personal.

Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në departamentin e tatimit në pronë.

Ndikimi

Vlerësimi i njësive rezidenciale me zbritje pa numër personal mund të rezultojë me kalkulim të parregullt të zbritjes apo shmangie nga tatimi në pronë, ku për pasojë komuna pranon më pak të hyra nga kjo kategori. Për më tepër, regjistrimi i numrave personal rrit efikasitetin, garanton informata më të sakta dhe të besueshme në regjistrin e tatimit në pronë.

Rekomandimi A1

Kryetari duhet të marrë veprime shtesë për të siguruar se janë bërë korigjimet e nevojshme në data bazën e tatimit në pronë, në mënyrë që zbritja për vendbanim parësor të bëhet vetëm për personat fizik të cilët janë të regjistruar me numër personal dhe kanë deklaruar në komunë se objekti shërben si vendbanim parësor.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,817,592€, prej tyre në 2023 ishin shpenzuar 4,307,122€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të objekteve sportive/kulturo, parqeve, blerje të pajisjeve si dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit.

Çështja B6 - Monitorimi i menaxhimit të kontratave jo përmes E-prokurimit

Gjetja	<p>Paragrafi 70.24.f. i Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik parasheh se “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.</p> <p>Menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve përmes sistemit elektronik të prokurimit publik.</p> <p>Kjo ka ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme.</p>
Ndikimi	<p>Mos mbajtja dhe arkivimi i kontratave përmes sistemit të prokurimit publik mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë të kontratave si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.</p>
Rekomandimi B6	<p>Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PVF e pasurive kapitale është 87,512,363€, pasurive jokapitale është 353,014€, si dhe e stoqeve 29,117€.

Çështja B7 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasurive në përdorim

Gjetja Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit, po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe vlerësimi.

Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€ kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara 277 pasuri në vlerë 8,723,506€ si investime në vijim. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2013-2023, për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar e që janë në proces ndër vite ose të pezulluara. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim.

Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.

Ndikimi Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduar, apo atyre që janë në proces dhe të pezulluara, ndikon në paqartësinë e statusit dhe raportimit të tyre. Kjo sjell mangësi dhe vështirësi në vlerësimin e saktë të pasurive të komunës, duke e bërë të vështirë menaxhimin efektiv të tyre.

Rekomandimi B7 Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduar dhe trajtimin e duhur të projekteve që janë në proces ose të pezulluara.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Komuna e Vitisë ka të themeluar Njësinë e Auditimit të Brendshëm (NjAB), e cila operon me vetëm dy (2) anëtarë, Drejtorin e njësisë, dhe një auditor. Po ashtu Komuna ka të themeluar Komitetin e Auditimit të Brendshëm (KA). NjAB kishte përgatitur planin strategjik dhe planin vjetor në bazë të të cilit ishte planifikur që të realizohen katër (4) auditime.

Çështja C1 - Mangësi në Sistemin e Auditimit të Brendshëm

Gjetja

Sipas plani vjetor të auditimit të brendshëm janë planifikuar që të kryhen katër auditime për vitin 2023 në përputhje me afatet e përcaktuara.

Njësia e auditimit të brendshëm nuk ka arritur të përmbushë planin vjetor të auditimit. Nga katër auditimet e planifikuara, ajo kishte arritur të realizonte vetëm dy prej tyre. Për më tepër, këto dy auditime përfshinin vetëm vitin 2022.

Mos përmbushja e planit vjetor ka ndodhur pasi që NJAB nuk ka qenë efektiv në përmbushjen e planit vjetor të auditimit.

Ndikimi

Mos përmbushja e planit të auditimit ndikon negativisht në përmirësimin e sistemeve të kontrollit dhe në arritjen e objektivave të saj, si dhe mos përfshirja e aktiviteteve të vitit aktual në auditim mund të ndikojë që mangësitë eventuale të mos identifikohen dhe adresohen me kohë nga menaxhmenti i komunës.

Rekomandimi C1

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që plani i auditimit të realizohet në tërësi dhe auditimet të përfshijnë edhe aktivitetet e vitit aktual.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁵	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,996,356	17,800,766	17,059,276	14,093,620	12,674,794
Grante Qeveritare - Buxheti	13,943,537	15,430,274	15,257,344	12,238,786	11,984,960
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	89,866	29,091
Të bartura nga viti i kaluar	0	351,521	340,713	643,369	71,516
Të hyrat vetanake	1,052,819	1,112,819	990,630	871,328	589,227
Donacionet vendore	0	81,856	74,181	31,153	0
Donacionet e jashtme	0	824,296	396,408	219,120	0

Buxheti përfundimtar është më i lartë se buxheti fillestar për 2,804,410€. Rritja ishte kryesisht si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar me vlerë 351,521€, të hyrat vetanake në vlerë të vitit aktual për 60,000€, nga grandit qeveritare në vlerë prej 1,486,737€, si dhe nga donacionet në vlerë prej 906,152€.

Në vitin 2023 Komuna e Vitisë ka shpenzuar 96% të buxhetit përfundimtar ose 17,059,276€, me një rënie prej 2% krahasuar me vitin paraprak 2022 (98%).


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,996,356	17,800,766	17,059,276	14,093,620	12,674,794
Pagat dhe mëditjet	7,609,386	9,121,405	9,096,106	7,938,162	8,211,491
Mallrat dhe shërbimet	2,432,765	2,628,867	2,569,043	2,230,790	1,674,384
Komunalitë	325,000	325,000	317,043	271,625	235,921
Subvencionet dhe transferet	570,000	907,903	769,962	458,713	251,801
Investimet Kapitale	4,059,205	4,817,592	4,307,122	3,194,330	2,301,197

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 1,512,019€ kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar, grantet e përcaktuara dhe Vendimet e Qeverisë së Kosovës për realizimin e ligjit të ri të pagave. Realizimi i buxhetit në këtë kategori ishte 100%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime gjithashtu ishte rritur për 196,102€, në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar dhe donacioneve. Ndërsa ekzekutimi i buxhetit është relativisht i lartë në këtë fushë me rreth 98%.
- Buxheti final për shërbime komunale ishte i njëjtë me buxhetin fillestar. Shpenzimi i buxhetit në këtë kategori në fund të vitit kishte arritur mbi 98%.
- Buxheti final për Subvencione dhe transfere ishte rritur për 337,903€, në krahasim me buxhetin fillestar, kjo rritje vjen si rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti i kaluar dhe granteve të donatorëve. Realizimi në këtë kategori ishte rreth 85% e buxhetit final.
- Buxheti final në krahasim me buxhetin fillestar për investime kapitale ishte rritur për 758,387€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti i kaluar dhe donacioneve. Buxheti në këtë kategori është shpenzuar rreth 89%.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga Komuna e Vitisë në vitin 2023 në total ishin 1,232,853€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave të realizuara nga Komuna të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, komuna ka pranuar edhe të hyra indirekte që janë realizuar nga niveli qendror (gjobat e gjykatave, gjobat pyjore dhe dënimet e trafikut) në vlerë totale prej 201,238€.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	1,052,819	1,052,819	1,232,853	946,309	936,236
Të hyrat tatimore	650,206	650,206	746,135	527,963	475,146
Të hyrat jo tatimore	402,613	402,613	486,718	418,346	457,718
Të hyrat tjera	0	0			3,371

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të të vitit 2022, ka rezultuar në 13 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit i vitit 2022 ishte diskutuar në Asamblenë Komunale. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, pesë (5) rekomandime janë zbatuar, Një (1) ishte në proces të zbatimit dhe shtatë (7) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë se zyrtarët përgjegjës mbajnë evidenca të sakta për llogaritë e arkëtueshme dhe të sigurohet se prezantimi i tyre në PFV është i saktë. Po ashtu, të ndërmerren veprimet e nevojshme për obligimin e tatimit në pronë për objektet në pronësi të institucioneve.	Komuna kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
2.	Baza për opinion	Kryetari duhet të sigurojë që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate të përcaktuara me plan kontabël, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV sipas standardeve të kontabilitetit në përputhje me planin kontabël.	Ky rekomandim nuk ishte zbatuar në mungesë të buxhetit.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë që gjatë ekzekutimit të pagesave për investime kapitale për të gjitha rastet, të respektohen shumat dhe kodet e projektit përkatës siç janë të miratuara në ligjin e ndarjeve buxhetore, dhe nëse paraqitet nevoja për ndryshimin e shumave apo të projekteve atëherë të kërkohet miratimi paraprak i Kuvendit Komunal.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se do të ndiqen procedura adekuate ligjore me rastin e angazhimit të stafit, në mënyrë që personat e angazhuar do të plotësojnë të gjithat kriteret për pozitat përkatëse, qoftë përmes Marrëveshjeve për Shërbime të Veçanta, apo në rast të pozitave të rregullta fillimisht të bëhet planifikimi sipas ligjit të buxhetit, e pastaj të zhvillohet proces i rregullt i rekrutimit.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të ndërmer veprimet e nevojshme për të siguruar që baza e të dhënave të tatimit në pronë plotësohet me të gjithë numrat personal të tatimpaguesve, ashtu që të mundësohet verifikimi i të gjitha rasteve potenciale që mund të hasen me përfitim të disahershëm për vendbanim parësor.	Ky rekomandim është zbatuar, nuk kemi hasur raste të zbritjeve të dyfishta nga mostrat e testuara.	I zbatuar
6.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se fillimisht Komisioni Vlerësues të themelohet në kohën sa janë të hapura thirrjet publike, me që rast të emërohen anëtarë kompetent, në mënyrë që aplikacionet të vlerësohen në pajtim të plotë me Rregulloren e lartpërmendur dhe kriteret e Thirrjeve Publike.	Komuna kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se janë forcuar kontrollet e brendshme në procesin e ekzekutimit të pagesave. Procedimi i pagesave duhet të bëhet sipas kronologjisë së ngjarjeve dhe në pajtim të plotë me hapat e përcaktuar me rregullën financiare për shpenzimin e parave publike.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimi
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimi

9.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që janë rishikuar regjistrat e pasurive në mënyrë që të evidentohen të gjitha pasuritë që janë të regjistruara si Investime në vijim e që janë të finalizuara si projekte dhe të pranuar teknikisht. Po ashtu, të bëhen ndryshimet në regjistrin kontabël, në mënyrë që atyre pasurive tu ndryshohet klasa dhe të aplikohet zhvlerësimi sipas normave të përcaktuara me rregullore.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
10.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë që inventarizimi i pasurive të kryhet në pajtim me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive si dhe të bëhet harmonizimi i raportit të inventarizimit me regjistrat kontabël të pasurive, para përgatitjes së PFV-ve të Komunës.	Komuna kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
11.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë që obligimet të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen brenda afateve kohore ligjore me qëllim që mos të dëmtohet buxheti i Komunës me kosto shtesë të përmbarimit.	Komuna nuk kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	Nuk ka filluar zbatimin
12.	Detyrimet Kontingjente	Kryetari duhet të sigurojë që gjatë përgatitjes së PFV-ve të rishikohen regjistrat e detyrimeve kontingjente dhe detyrimeve/faturave të pa paguara në mënyrë që të shmangen dyfishimet e mundshme dhe informatat të prezantohen drejtë dhe saktë në PFV.	Komuna kishte ndërmarrë masa për ta adresuar këtë rekomandim.	I zbatuar
13.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari i Komunës duhet të sigurojë burime të mjaftueshme për NJAB-në në mënyrë që plani i auditimit të realizohet në tërësi dhe auditimet të përfshijnë edhe aktivitetet e vitit aktual. Çdo raport i auditimit të brendshëm duhet të pasohet me një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve dhe i njëjti të përcillet sipas orarit të implementimit. Po ashtu Komiteti i Auditimit duhet të mbajë së paku katër takime brenda vitit në mënyrë që të ofrojë kontributin e tij konform obligimeve të përcaktuara me rregullat në fuqi.	Komuna kishte rekrutuar staf për NJAB, megjithatë nuk ka arritur të përmbush planin e auditimit për vitin 2023 dhe se auditimet e realizuara nga NJAB përfshijnë periudhën e vitit 2022.	Pjesërisht i zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Arian Haxha, Udhëheqës i ekipit



Imer Vitia, Anëtar i ekipit



Veton Misiri, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve në kategorinë ekonomike	Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet por nuk pajtohem me bazën për kualifikim të raportit që përmes pagesave direkte nga thesari bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2023 transaksionet në vlerë 436,088€ ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta, përkundur njoftimeve tona (ju kemi ofruar dëshmitë) që të mos ekzekutohen nga kategoritë tjera veç pagave dhe mëditjeve por thesari i shtetit nuk i ka marr parasyshë kërkesat tona dhe ka ekzekutuar pagesa duke bërë keqklasifikim të shpenzimeve si ceket në raport.	E gjetura qëndron, ndonëse pagesat janë ekzekutuar nga Thesari. Në bazë të dëshmive pagesat për paga jubilarë dhe shujta janë realizuar nga kategori ekonomike joadekuatë dhe kjo ka ndikuar në prezantim jo të saktë dhe të drejtë në PFV.



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA			
Pranuar - Primjena Më/Dana 06.06.2024			
Nr./ organii Ora./ broj	Numri/ Broj	Shtetlloç Prilog	Vlera Vendimeve
02-	016/1-	1-	855

Komuna e Vitisë

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Vitisë, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet por nuk pajtohem me bazën për kualifikimin të raportit që **Përmes pagesave direkte nga Thesari** bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2023 transaksione në vlerë 436,088€ ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta, përkundër njoftimeve tona (ju kemi ofruar dëshmitë) që të mos të ekzekutohen nga kategorit tjera për veç pagave dhe mëditjeve por Thesari i shtetit nuk i ka marr parasysh kërkesat tona dhe ka ekzekutuar pagesa duke bërë keq klasifikim të shpenzimeve si ceket në raport .
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Sokol Habiri, Kryetar i Komunës

Data: 03.06.2024, Viti



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁶ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁷, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.